

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "MARA INT&SERVICES" SHPK
ME SELI NË TIRANË

Sot, më date 02 /11 /2022, në Tiranë,

Z. Erban Pelinku, Shtetas Shqiptar, i lindur më date 23/04/1986 në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, Leternjoftim ID nr. 033988395 dhe nr. personal I60423008V.

Vendosi të krijojë shoqërinë **MARA INT&SERVICES**, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat si më poshtë:

NENI 1.

SHOQËRIA TREGTARE **MARA INT&SERVICES**, krijohet në formën e Shoqërisë tregtare sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" (në vazhdim Shoqëria).

Kompania është person juridik privat Shqiptar.Zyra e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës.

NENI 2.

Emri i Shoqërisë

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj me emrin tregtar:**EMARA INT&SERVICES shpk.**

NENI 3.

Objekti i veprimtarisë ekonomike

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me dispozitat e ligjit - këto aktivitete:

Parkim automjesh, Larje Automjesh,Larje Tapicerie te te gjitha llojeve,larje perde,larje tapeta,lucidime automjesh.Konsulenca tregtare,konsulenca juridike,import-eksport,shitje makinash dhe pajisjesh rrobaqepesie,shitje me pakice e tekstileve,shitje me pakice, shitje online, etj..

NENI 4.

Selia e kompanisë

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga e Kavajes, pasuria nr. 1/710-G52+ 1/710-G53,Blloku i pallateve Arlis Construction,Kati -1,Tirane.**

NENI 5.

Kapitali i shoqërisë



Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut të vetëm, z. Erban Pelinku, në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Kontributi i Ortakut të vetëm në kapitalin themeltar është 1 kuotë, me vlerë 10.000 lekë, zotëron 100% të kapitalit.

NENI 6.
Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kompania ushtron veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

NENI 7.
Organet drejtuese

Referuar ligjit n. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë krijohen si më poshtë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori.

Forma dhe rregullat e organizimit të Shoqërisë janë të parashikuara në statutin e Shoqërisë.

Shoqëria fillimisht administrohet nga një Administrator i vetëm i cili do të qëndrojë në detyrë për 5 vjet, i rinovueshëm, përveç rasteve kur revokohet ose jep dorëheqjen, ose për arsye të tjera ligjore.

Administrator i Shoqërisë, do të jetë Erban Pelinku, shtetas Shqiptar, i lindur më 23/04/1986, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me nr. personall60423008V.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, publik ose privat, gjithashtu në marrëdhënie juridike me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto kompetenca në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi. Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm, edhe jo ortak, ose nga disa administratorë edhe jo ortakë, sipas asaj që është përcaktuar në momentin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë u është besuar disa personave, vendimi i emërimit përcakton në mënyrë alternative:

- a) nëse administratorët do të funksionojnë në mënyrë kolegjiale, duke formuar kështu këshillin e administrimit;
- b) nëse administrimi i është caktuar veçmas apo bashkërisht.

NENI 8.

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë, hapja e zyrave apo degëve dytësore do të bëhet në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar dhe të Statutit.

NENI 9.



Punonjësit dhe të ngarkuarit me drejtimine Shoqërisë janë përgjegjës dhe duhet të kompensojnë kompaninë për dëmet e shkaktuara me dashje per faj te tyre gjatë ushtrimit të veprimtarise së tyre.

NENI 10.
Ligji në fuqi

Veprimtaria e shoqërisë do të drejtohet nga rregullat e statutit të nënshkruar nga anëtarët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11.
Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me themelimin e shoqërisë do të zgjidhet nga ortaket në të kundërt mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12.
Dispozitat përfundimtare

Akti i themelimit hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua nga anëtari përbërës, u konstatua në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe nënshkruhet pa asnjë vërejtje.

ORTAKU THEMELUES

ERBAN PELINKU

Erban Pelinku

